GJIROKASTRA

QYTET-MUZE

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»
TIRANË 1978

DR998
.G5G5
1978x
RL



TË TREGOHET KUJDES I MADH PËR TA RUAJTUR E ZBUKURUAR MË TEJ KËTË QYTET, QË ËSHTË NJË ANSAMBËL I MREKULLUESHËM ARKITEKTURAL I NDËRTUAR ME MJESHTËRI NGA TË PARËT TANË, NGA MURATORËT E GURËGDHËNDËSIT E TALENTUAR.

ENVER HOXHA

GJIROKASTRA
QYTET - MUZE

Gravurë e shek. XIX.

Qyteti-muze i Gjirokastrës, është një nga qendrat e rëndësishme me vlera shumë të mëdha arkitektoniko-urbanistike, që hedhin dritë mbi natyrën e qytetit të vonë mesjetar shqiptar. Me kujdesin e vazhdueshëm të Partisë për trashëgiminë e kulturës materiale të popullit tonë, ky qytet, ashtu si të gjithë monumentet e kulturës, është vënë në mbrojtje shtetërore. Puna e gjerë studimore dhe restauruese e kryer deri më sot në Gjirokastër krijoi kushtet për daljen në dritë të këtij albumi, i cili përpiqet të japë në mënyrë të përmbledhur vlerat arkitektoniko-urbanistike të këtij qyteti-muze. Realizimet e rëndësishme arkitektoniko-urbanistike të Gjirokastrës, janë dëshmi bindëse e vitalitetit të popullit tonë të lashtë, e nivelit të lartë të kulturës sonë popullore. Shoku Enver Hoxha, nga tribuna e Kongresit të VII të PPSH theksoi: «Karakteri kombëtar dhe fryma popullore realizohen duke pasqyruar me vërtetësi realitetin nga pozitat e ideologjisë marksiste-leniniste, duke asimiluar në mënyrë kritike dhe nga pozita klasore gjithë përvojën e kulturës sonë, traditën e vjetër përparimtare dhe të renë revolucionare, duke u mbështetur fort në krijimtarinë e popullit»[1]). Njohja sa më e plotë dhe e thelluar me karakterin dhe historinë e zhvillimit të qytetit-muze të Gjirokastrës, krahas arritjeve të kulturës sonë popullore në përgjithësi ndihmon në realizimin e frymës dhe fizionomisë kombëtare edhe në arkitekturë.

Kriteri bazë në ndërtimin e albumit ka qënë paraqitja e zhvillimit të fenomeneve arkitektonike, duke drejtuar objektivin mbi shfaqjet dhe elementet thelbësore dhe më tipike të ndërtimeve. Prandaj albumi u shërben jo vetëm masave të gjera, por edhe studjuesve të ndryshëm që interesohen tërthorazi apo drejtpërdrejt për arkitekturën shqiptare.

Në album është bërë një ndarje me karakter tematik në katër njësi, duke filluar, së pari me lindjen dhe zhvillimin e qytetit, gjë që jepet nëpërmjet përbërësve kryesorë të tij: kalasë, pazarit, lagjeve të banuara dhe ndërtimeve të kultit. Vendin kryesor në album e zë banesa gjirokastrite, një nga realizimet më

---

1) Enver Hoxha, Raport në Kongresin e VII të PPSH. bot. 1976, f. 178.

të shënuara të banesës shqiptare, si në planin e përgjithshëm tipologjik, ashtu dhe në trajtimin e jashtëm dhe të brendshëm. Pas kësaj jepet një panoramë e arritjeve të derisotme, lidhur me veprimtarinë restauruese në qytet, si dhe një pjesë e ndërtimeve të reja të kohës sonë. Një vend i veçantë i është kushtuar në album paraqitjes së ndërtesave me vlera historike që lidhen me ngjarje të rëndësishme të qytetit ose me personalitete të shquara në luftën për liri dhe pavarësi, si dhe përmendore apo lapidarë të ngritur për të përjetësuar figura e ngjarje të shquara patriotike dhe revolucionare.

QYTETI – MUZE I GJIROKASTRËS

Qyteti i Gjirokastrës zë një pozitë qendrore në luginën e Drinos. Rrugë të ndryshme e lidhnin që në lashtësi këtë qendër me Vlorën, pellgun e Delvinës dhe, përmes grykës së Këlcyrës, me shumë qendra të tjera të Shqipërisë Jugore. Krahinat malore të Kurveleshit të Sipërm, Pogonit dhe Zagorisë, si dhe ato të Dropullit e Lunxherisë, kanë qenë prej kohësh të lidhura me Gjirokastrën si kryqendër e zonës.

Qyteti shtrihet mbi një terren mjaft të aksidentuar, që karakterizohet nga një përthyerje e rrëzës së Malit të Gjerë, e cila përmban kurrize, luginëza, shpate me pjerrësi të ndryshme dhe shumë pak sheshe. Mbi këtë truall kaq dinamik e plot kontraste thuajse në qendër, ngrihet një kodërzë me konture të mprehta dhe në përgjithësi me rënie thikë, mbi të cilën është ndërtuar kalaja, zanafilla e qytetit dhe epiqendra kompozicionale e tij. Pozita e saj karshi lagjeve të hapura ka ruajtur gjithmonë një rol të dorës së parë në pamjen e qytetit, ndërsa roli funksional i saj, si ndërtim mbrojtës bie duke filluar rreth gjysmës së dytë të shek. XIX.

Nga të dhënat e derisotme, njoftimi më i hershëm për qytetin e Gjirokastrës i përket vitit 1336, prej kronistit bizantin I. Kontakuzeni. Ky autor e përmend Gjirokastrën në trajtën «Argyrokastron», një herë qytet e pastaj kështjellë. Gjatë gjysmës së dytë të shek. XIV, Gjirokastra u bë qendër e zotërve feudalë Zenevisë, ndërsa më 1419 ajo ra në duart e pushtuesve turq. Për rolin e rëndësishëm që luante Gjirokastra gjatë shek. XV në trevat e Shqipërisë Jugore, ajo u caktua kryeqendra e Sanxhakut të Shqipërisë. Të dhënat më të sakta për qytetin vijnë nga regjistri fiskal i vitit 1431-32. Sipas tij Gjirokastra në këtë kohë kishte 163 banesa. Zgjerimi i qytetit jashtë mureve rrethues duhet t'i përkasë gjysmës së parë të shek. XIV.

Gjatë shek. XV, Gjirokastra u zvogëlua si qytet, duke numëruar në vitet 1506-1507 vetëm 143 banesa. Gjatë shek. XVI dhe më tej, ajo fillon rritjen e saj duke arritur të ketë 434 banesa në vitin 1583. Gjatë shek. XVII rritja bëhet më e ndjeshme, kryesisht për shkak të fillimit të shthurjes së ekonomisë natyrore të fshatrave. Është koha kur Gjirokastra kishte arritur thuajse shtrirjen e sotme, duke u hedhur kështu linjat kryesore të kompozimit urbanistik.

Të dhënat për zhvillimin e qytetit gjatë shek. XVIII thuajse mungojnë. Ato fillojnë sërish aty nga fillimi i shek. XIX nga albanologë dhe udhëtarë të huaj. Këto të dhëna lidhen me periudhën më të pasur dhe më intensive të ndërtimit të qytetit, që pasohet me krijimin e ansambleve të rinj dhe kompaktësimin e atyre ekzistues.

Në zhvillimin urbanistik të Gjirokastrës një rol me rëndësi ka luajtur terreni i veçantë. Kjo ka bërë që lagjet e banuara të qëndrojnë pak a shumë si njësi më vehte. Por këto njësi nuk shkëputen aq sa të copëtojnë kuadrin unik të qytetit. Grupin më karakteristik dhe njëherazi më piktoresk të ansambleve në qytetin e Gjirokastrës e përbëjnë lagjet «Pazar i Vjetër» dhe «Pllakë», si dhe ai i lagjes «Hazmurat», të ngritura mbi dy kreshta thuajse paralele. Kompaktësia e ndërtimeve, lidhja e goditur me truallin dhe larmia e pamjeve të tyre, i shquajnë këto lagje në

GJIROKASTRA
QYTET - MUZE

mbarë qytetin. Ndryshe kompozohen ansamblet e mëdhenj të lagjes «Palorto» dhe «Manalat», të ngritura mbi terrene të pjerrëta në formë pllaje. Në pamjen e tyre këto lagje paraqiten si blloqe, trajtuar me të njëjtën shprehje arkitektonike, ku spikat mirë volumi i banesës. Këto ansamble shquajnë për monumentalitet dhe një farë uniformiteti brenda kuadrit dinamik të Gjirokastrës. Të dy ansamblet e lagjes «Dunavat», që përbëjnë njësi të lidhura mjeshtërisht me truallin, janë kompozuar më lirshëm dhe ndërtimet shfaqen më qartë individualisht, duke bërë më të larmë kompozimin, pa cënuar unitetin e tij. Trajtimin më të lirë dhe njëherazi mjaft piktoresk e ndeshim në lagjen «Cfakë». Ky ansambël shquan për lidhjen e goditur me truallin dhe gjelbërimin e pasur.

Gjirokastra bën pjesë në grupin e atyre qendrave qytetare që ngrihen mbi terrene të pjerrëta dhe që përgjithësisht e kanë zanafillën e tyre në kalatë. Në këtë grup të madh dhe më karakteristik të qyteteve shqiptare, Gjirokastra shquan për larminë e theksuar të relievit, i cili ka kushtëzuar tiparet e veçanta të lagjeve të banuara, si dhe dinamizmin e theksuar të kompozimit, Gjirokastra nuk rroket me një shikim të vetëm, por shfaqet me pamje të ndryshme nga pika të ndryshme; ajo shpesh i fshihet shikimit, për t'u rishfaqur më tutje më tërë monumentalitetin e saj. Formulimi urbanistik i kësaj qëndre dhe vlerat urbanistike, tregojnë sheshit se zhvillimi i Gjirokastrës u është përmbajtur disa parimeve dhe normave, të cilat janë ndjekur nga qytetarët dhe zbatuar mjeshtërisht nga ndërtuesit e këtij qyteti, që përmbledh në shkallën më të lartë shkrirjen e asaj që është natyrale me atë të krijuar nga dora e njeriut.

Një nga ndërtimet më madhështore të qytetit është padyshim kalaja. Zhvillimi i mureve të saj rrethues, i është përshtatur terrenit. Ajo ka tre hyrje kryesore dhe ruan relativisht mirë shumë përbërës të saj. Ndërtimi i kalasë, sipas të dhënave të derisotme, i përket gjysmës së dytë të shek. XIII. Ajo në gjëndjen e sotme paraqitet me dy faza ndërtimi. Faza e parë, apo më saktë vetë kalaja, linte jashtë fortifikimit pjesën jugperëndimore. Kjo pjesë që përbën fazën e dytë, i përket veprimtarisë ndërtuese të Ali pashë Tepelenës dhe pikërisht viteve 1811-12. Krahas mureve rrethuese, kalaja ruan brënda saj një sërë ndërtimesh, mjaft prej tyre të rrënuara, që flasin qartë për qëndrimin brënda saj jo vetëm të garnizoneve ushtarake, por dhe të banorëve. Në kalanë e Gjirokastrës, si në pjesën paraturke ashtu dhe në atë të ngritur nga Ali pashë Tepelena, ndeshim në ndërtime të guximshme nga ana inxhinjerike, siç janë mbulimi i sipërfaqeve të mëdha me sistemin e qemereve etj. Në sajë të punimeve të vazhdueshme restauruese u bë e mundur ngritja në të e Muzeut Kombëtar të Armëve dhe fitimi i mjaft prej vlerave të humbura nga koha.

Për t'u përmëndur është dhe ujësjellësi i kalasë më gjatësi rreth 10 km., i cili shfrytëzonte ujërat e një burimi në Malin e Sopotit. Ndërtimi i këtij ujësjellësi, rreth viteve 1811-12, u shoqërua me mjaft vepra arti, ndër të cilat shquante ura me dy palë arkada në lartësi, që lidhte Shkëmbin e Çeribashit me Kalanë, shkatërruar përfundimisht nga regjimi antipopullor monarkik, si dhe një urë tjetër mbi lagjen Manalat.

Një kompleks ndërtimor me rëndësi është gjithashtu pazari i qytetit. Të dhënat burimore bëjnë të

ditur se fillimisht pazari ngrihej më pranë kalasë, pikërisht aty ku sot ruhet toponimi «Pazar i Vjetër». Rreth fillimit të shek. XVII, nisi ndërtimi i pazarit të ri, në truallin ku ai gjendet sot, pra në qendër të qytetit. Përsa i përket raportit me pjesën e banuar të qytetit, edhe pazari i Gjirokastrës, ashtu si mbarë qendrat zejtaro-tregtare të qyteteve shqiptare të kohës, përbën një njësi më vehte të shkëputur nga zona e banuar. Vendshtrirja dhe formulimi i linjave kryesore urbanistike të pazarit, u përkasin shekujve XVII--XVIII. Krejt ndryshe ndodh me ndërtimet që formojnë pazarin, të cilat, në gjendjen e sotme, i përkasin kryesisht gjysmës së dytë të shek. XIX si dhe fillimit të shek. XX. Rreth çerekut të tretë të shek. XIX, pas një zjarri të madh shkatërrues, pazari pësoi një rindërtim thelbësor. Gjatë këtij rindërtimi u zgjeruan rrugët, duke ruajtur akset origjinale dhe u rindërtuan blloqe të tërë dyqanesh, duke marrë kështu thuajse pamjen e sotme. Nga ana e vendosjes urbanistike, pazari i Gjirokastrës ndjek skemën klasike për këto lloj komplekse, duke krijuar me ndërtimin e vargjeve paralele të dyqaneve, të përngjitur, blloqe prej disa dyqanesh. Terreni i pjerrët ka kushtëzuar zhvillimin e ndërtimeve me shkallëzime blloqesh; duke u dhënë kështu një lëvizje të madhe volumeve. Formulimi i jashtëm arkitektonik është unik, dëshmi kjo e periudhës së njëjtë të ndërtimit. Të bie në sy përdorimi i gjerë i gurëve të latuar me të cilët janë veshur kollona dhe pilastra, janë formuar korniza, ose janë konturuar hapësirat e dritareve. Në këto ndërtime mbisundon linja e drejtë, por nuk mungojnë as zgjidhjet me harqe. Pazari i qytetit shquan jo vetëm për trajtimin e njëjtë arkitektonik, por ajo që e dallon më fort atë, është se ky përpunim ecën paralelisht me trajtimin e banesës gjirokastrite të së njëjtës periudhë. Ky unitet, e përfshin mirë pazarin, si kompleks arkitektonik, në tërësinë e qytetit. Funksionin e dikurshëm, pazari, sot i restauruar, vazhdon ta ruajë dhe në ditët tona.

Në Gjirokastër janë ndërtuar dhe një numër objektesh shoqërore dhe kulti, të shpërndara në lagjet e ndryshme të qytetit. Këto të fundit, pas flakjes së besimit fetar nga vetë populli, ruhen vetëm për vlerat e tyre arkitektonike. Përmasat, formulimi i tyre, si dhe karakteri i theksuar monumental i banesës gjirokastrite, bëjnë që ato të mos spikasin qartë në ansamblet ku bëjnë pjesë. Për t'u përmendur janë xhamija e lagjes Meçite, e cila mund të jetë ndërtuar në gjysmën e parë të shek. XVII. Ndërtimi nuk paraqet vlera të veçanta, me përjashtim të një çesme në trupin e pjesës së poshtëme të minares, rast ky unikal. Vlera të rëndësishme ruan xhamia e Pazarit e vitit 1757. Minareja prej guri konkuron kupolën dhe theksón monumentin e veprës, megjithëse me vlera të rëndësishme, nuk luan rolin e duhur në kompozimin e qëndresës, për shkak të ultësirës së truallit në vendin ku ngrihet. Xhami të tjera, por më të vogla, kanë qenë ndërtuar edhe në lagje të tjera të qytetit. Në krahasim me xhamitë e qyteteve të tjera shqiptare, ato të Gjirokastrës nuk paraqesin ndonjë veçanti tipologjike. Ajo që i dallon xhamitë e Gjirokastrës janë përmasat e vogla dhe ç'është më e rëndësishme përpunimi i pakët në planin dekorativ, veçanërisht të pamjes së jashtme. Xhamitë e Gjirokastrës janë tipike monokrone. Ngjyra e përhirtë e gurit i jep tonin pamjes së jashtme. Ky monokronizëm ka bërë që volumet formuese të ndërtimit të punojnë plotësisht duke i dhënë pamjes së jashtme një notë të theksuar monumentaliteti. Ashtu si dhe pazari, këto ndërtime, qoftë në trajtimin e tyre të përgjithshëm se dhe në atë të hollësive arkitektoniko-konstruktive, shkrihen plotësisht me karakterin e arkitekturës së qytetit, prej së cilës janë ushqyer në shumë drejtime.

Ndërtime me vlera arkitektonike paraqesin dhe dy kishat e qytetit të tipit bazilikal. E para ndërtuar në lagjen «Pazar i Vjetër» më 1784, ndërsa e dyta në atë «Varosh» më 1776 dhe rindërtuar më 1833 pas djegies. Banja e vetme publike e qytetit e ndërtuar në

GJIROKASTRA
QYTET - MUZE

lagjen «Meçite», me sa duket i përket fillimit të shek. XVII.

Kategoria ndërtimore që i jep tonin qytetit është banesa, e cila me karakterin e fortë monumental dhe arritjet e shënuara, është elementi themelor kompozicional. Banesa gjirokastrite me një numër relativisht të madh variantesh, zë një pozitë të veçantë, duke përbërë një tip më vehte në tipologjinë e banesës qytetare shqiptare me karakteristika të qarta në planin e kompozimit planimetriko-volumor dhe dallime në elemente të veçanta arkitektoniko-konstruktivë.

Banesa gjirokastrite, gjithë duke ruajtur karakteristikat e saja thelbësore në planin e përgjithshëm arkitektonik, ka një ecuri të dallueshme në kohë, fillimet e së cilës, mjaft të largëta, përfundojnë aty rreth fillimit të shek. XX. Kjo ecuri e këtij tipi të banesës qytetare shqiptare, që shpreh vetë ecurinë e mënyrës së jetesës, tregon gjithashtu për diapazonin e gjerë të mundësive që përmbante ky tip, një nga më të shquarit e banesës shqiptare. Variantet e kësaj tipologjie shfaqen me një numër edhe më të madh nënvariantesh, duke ofruar shembuj shumë mësimdhënës, që tregojnë se kjo tipologji nuk qe një arritje, e cila më tej u bë diçka e pandryshueshme dhe shabllone, po përkundrazi ajo u kuptua mjaft gjerë, si një sintetizim i përvojës, e cila lejonte kufij relativisht të gjerë për kontribute të reja, në përputhje me kushtet konkrete të çdo rasti. Diferencimi klasor në kushtet e shoqërisë shfrytëzuese, shprehet shumë qartë në tipologjinë e pasur të banesës gjirokastrite.

Banesa gjirokastrite, duke pasur si kriter bazë klasifikues atë të kompozimit planimetriko-volumor, zhvillohet në tre variante: varianti perpendikular, varianti me një krah dhe varianti me dy krahë. Përpos këtyre, ka edhe zgjidhje të veçanta, të cilat, megjithëse nuk përfshihen në ndonjërin prej varianteve të sipërpërmendura, janë konceptuar në frymën e banesës gjirokastrite.

Varianti perpendikular është ai më i thjeshti i banesës gjirokastrite dhe njëherazi baza e zhvillimit të mëtejshëm tipologjik të saj. Nga ana kompozicionale ai paraqet një bllok prizmatik me bazë katërkëndësh kënddrejtë, që zhvillohet në lartësi me dy dhe tre kate. Ndërlidhja e dy kateve të parë bëhet me shkallë të jashtme guri: Kjo banesë shquan për karakterin e mbyllur, që i jep asaj tipare të dalluara mbrojtëse, kompozimin e thjeshtë dhe të ngjeshur, vendosjen karakteristike ndaj terrenit, si dhe për hedhjen e theksuar në lartësi.

Varianti me një krah përbën llojin më të përhapur të banesës gjirokastrite. Ai është përvetësuar mjaft mirë nga mjeshtrat popullorë, të cilët duke ruajtur principet kryesore kompozicionale, kanë arritur në mjaft shembuj zgjidhje ku shquan një koncept i shëndoshë krijues. Varianti me dy krahë, një nga më karakteristikët e banesës gjirokastrite, ku ajo gjen mundësi për një trajtim më të përpunuar dhe monumental, është niveli më i lartë ku arriti kjo banesë. Në të dyja këto variante, banesa gjirokastrite gjen shprehjen e saj më të plotë dhe më të përkryer. Të dhënat e derisotme tregojnë se formimi i tyre i përket fillimit të shek. XVIII, duke qenë shtyrja më tej në kohë një hipotezë mjaft e bazuar.

Morfologjia e banesës gjirokastrite tregon qartë për lidhjen e padyshimtë gjenetike ndërmjet varianteve të saj. Të gjitha këto forma të ndryshme i bash-

kon një koncept i vetëm, por i ndan shkalla e zhvillimit, mënyra konkrete e realizimit. Kjo vazhdimësi dhe larmi formash, si dhe numri i tyre i shumtë, janë argumente kuptimplote për të treguar se këtu kemi një ecuri të natyrshme të kësaj kategorie arkitektonike. Krahas zhvillimit në planin planimetriko-volumor, banesa gjirokastrite pasurohet dhe përdor një repertor përherë dhe më të gjerë formash dhe elementësh arkitektoniko-konstruktivë, të cilët, në unitet me skeletin hapësinor kanë dhënë realizime me të vërtetë të shënuara. Periudha prej viteve 1800-1830 mund të konsiderohet periudha klasike e banesës gjirokastrite. Gjatë kësaj kohe janë ndërtuar një numër i konsiderueshëm banesash të mëdha, me vlera të shquara arkitektonike, që bartin më qartë karakteristikat thelbësore të këtij tipi. Banesa gjirokastrite, gjithë duke u qëndruar besnike disa parimeve themelore në rrjedhje të zhvillimit të saj, ka fituar karakteristika të reja dhe ka zbehur apo humbur disa të vjetra.

Banesa gjirokastrite shquan për zhvillimin e saj në lartësi. Ajo përgjithësisht është trekatshe, por në disa raste ndeshen dhe të tilla, ose pjesë të saj, që zhvillohen në katër kate. Planimetria e banesës shquan për kompaktësinë e theksuar. Ajo luhatet në forma të ndryshme, duke ruajtur grupimin e ambienteve rreth atyre ndërlidhës. Ambientet komunikojnë me këto të fundit dhe shpesh ndërmjet tyre. Njësia bazë kompozicionale është varianti perpendikular trekatësh, i cili sipas rastit, duke u përsëritur, krijon skema të ndryshme. Në kompozimin e saj, banesa gjirokastrite ka një liri të madhe veprimi. Kështu, brenda të njëjtit variant ndeshim zgjidhje të ndryshme, sidomos përsa i përket konturimit planimetrik, i cili është shpesh mjaft i thyer. Volumet gjithashtu thyhen, duke i dhënë ndërtimit një theksim më të madh në lartësi dhe në mjaft raste duke pasuruar ndjishëm pamjet anësore. Por ajo që i jep planimetrisë dhe volumit të banesës gjirokastrite një zhdërvjelltësi dhe rritje, duke kaluar nga kati përdhes në ata të sipërmit, është koncepti i gjysmëkatit. Terreni i pjerrët ka krijuar mundësinë e rritjes së sipërfaqes për çdo kat, duke siguruar kështu një lidhje shumë organike me truallin. Gjirokastra, ashtu si dhe Berati, na jep një mori shembujsh të përkryer të lidhjes së goditur të ndërtimeve me terrenin.

Banesa gjirokastrite, që me formimin e variantit perpendikular trekatësh, fitoi një diferencim të dallueshëm funksional sipas kateve, gjë që mbeti deri aty rreth viteve 80 të shekullit të kaluar një tipar i rëndësishëm i saj. Humbja e kësaj karakteristike, lidhet pikërisht me kalimin e disa ambienteve të banuara edhe në katin përdhe, i cili tashmë nuk mbeti si më parë i pabanuar.

Ajo që të bie në sy në variantet e ndryshme të banesës gjirokastrite, në ambientet e saj, si dhe në elementet e veçantë arkitektoniko-konstruktivë, është prirja e theksuar tipizuese. Vërtet ky tipar është një karakteristikë e përgjithshme e ndërtimeve popullore, po në rastin e dhënë, ai shfaqet me një qartësi të plotë. Është me interes të theksohet se ky tipizim nuk ka dëmtuar thuajse aspak origjinalitetin e çdo ndërtimi të veçantë, i cili ka paraqitur problemet e veta për ndërtuesin. Ky i fundit, brenda një repertori të njohur formash, ka ditur të japë në çdo rast një krijim më vehte. Tipizimi nuk ka tulatur shpirtin novator të ndërtuesit, por ka shërbyer si një mbështetje e sigurtë, tashmë e përvehtësuar, mbi të cilën e reja mund të ngrihej vetëm duke provuar racionalitetin e saj.

Banesa gjirokastrite shquan për një studim të detajuar funksional të çdo elementi, i cili është i vendosur pikërisht aty ku duhet të jetë. Kjo shihet më qartë në brendësinë e saj aq të pasur me orendi fikse si musandra, dollapë muri, kamare, mindere etj. Orenditë fikse, të lidhura organikisht me ndërtimin, përbëjnë një tipar të rëndësishëm të banesës gjirokastrite, ashtu si dhe për mbarë banesën shqiptare. Kjo zgjidhje lejonte që volumi i dhomës të mbetej thuajse i pastër. Përveç shtresave të ulta, asgjë nuk e pengonte shikimin, asgjë nuk e thyente volumin e brendësisë së dhomës, e cila shfaqej me tërë ngrohtësinë e saj. Elementet e drurit, shpesh të përpunuara nga ana dekorative, luajnë një rol të rëndësishëm në perceptimin tërësor të dhomës. Në përputhje me funksionin e çdo ambienti përpunimi dekorativ ka shkallëzime; realizimet më të shënuara janë në odën e miqve.

Oda e banesës gjirokastrite është elementi bazë kompozicional. Ndër odat, si përgjithësisht në banesën shqiptare, nga funksioni e për pasojë nga trajtimi, shkëputet oda e miqve, ndërsa të tjerat ndahen në të dimrit në katin e ndërmjemë dhe në të verës në të dytin.

Në dallim nga brendësia, që ka një trajtim mjaft të kujdesshëm arkitektonik, pamja e jashtme e banesës gjirokastrite, duke përfshirë dhe periudhën klasike të saj, është pak e përpunuar. Për vetë kompozimin, kujdes i kushtohet vetëm trajtimit të pamjes kryesore, ndërsa, në disa variante të zhvilluara, takojmë edhe pamjet anësore të përpunuara. Ajo që të bën përshtypje në banesën gjirokastrite të shikuar së jashtmi, është modelimi, kompozimi i hedhur dhe, mbi të gjitha, monumentaliteti dhe karakteri i ashpër që e shquajnë atë menjëherë nga tipat e tjerë të banesës shqiptare. Në pamjen e saj mbisundojnë masat e mbyllura të muraturës, ndërsa çardaku dhe trajtimi i ballit të katit të dytë mezi thyejnë pak ashpërsinë e saj, duke krijuar një kontrast të goditur me pjesën tjetër të ndërtesës. Lehtësia dhe përpunimi i ballit të katit të dytë si dhe strehët e gjera që mbështeten plot elegancë mbi testeket piktoreskë, pa humbur hijen e rëndë, i japin kompozimit një shpërthim të goditur, i cili vjen si një rritje graduale prej katit përdhe, thuajse të shurdhër. Diferencimi funksional i kateve ka gjetur shprehjen e barasvlershme në trajtimin e jashtëm arkitektural. Në pamjen e jashtme, detaji arkitektonik punon pak, elementet e veçantë përgjithësisht janë shkrirë bashkë, duke dhënë secili kontributin e vet për theksimin e karakterit monumental të pamjes së jashtme. Por, në disa shembuj të varianteve të zhvilluara, shohim që ballët e odave të krahëve dhe në disa raste, faqet anësore, që shohin nga kamerieja apo çardaku, janë të zbukuruara me dekoracione ose dhe me piktura murale. Përgjithësisht, balli i odës së miqve dekorohet me panotë karakteristike baroke, që i gjejmë dhe në brendësi të odave të miqve, ndërsa anash tyre pikturohen zakonisht dy luanë në një pozicion dinamik, kundrejt njëri-tjetrit.

Një nga tiparet e rëndësishme të banesës gjirokastrite është edhe karakteri mbrojtës i saj. Ky tipar nuk është i njëjtë në kohë. Atë e ndeshim në rritje deri në fundin e periudhës së lulëzimit të banesës gjirokastrite, më pas fillon të bjerë në mënyrë të ndjeshme, duke u shuar krejtësisht rreth fundit të shek. XIX. Kur flasim për tiparin mbrojtës, gjithashtu duhet të kemi parasysh se jo të gjitha banesat gjirokastrite e kanë këtë tipar; po ashtu atë e ndeshim në shkallë të ndryshme në banesa të ndryshme.

Banesa gjirokastrite, pa dyshim, nuk është një fenomen arkitektonik i izoluar. Ajo ka jetuar në një mjedis relativisht të gjerë kohor dhe hapësinor. Por lidhjet e saj me simotrat përreth kanë pasur shtrirje

GJIROKASTRA
QYTET - MUZE

dhe dendësi të ndryshme, në kohë të ndryshme. Ashtu si për mbarë banesën qytetare shqiptare, dhe për atë gjirokastriten, gjysma e dytë e shek. XIX është periudha gjatë së cilës ajo shënon ku më shumë e ku më pak ndryshime. Është koha kur thellohen shkëmbimet ekonomike ndërmjet krahinave, kur borgjezia kombëtare kishte filluar të rritej. Në këtë periudhë edhe banesa gjirokastrite u përfshi në atë rrymë konceptesh të reja, e cila u ndje në mënyrë krejt të pabarabartë në të dy përbërësit e saj themelorë, kompozimin planimetriko-volumor dhe trajtimin arkitektonik. Në planin e kompozimit, banesa gjirokastrite ruajti pothuaj të pacenuar skemën e saj, e cila, edhe gjatë kësaj periudhe, ruante vitalitetin. Përkundrazi, në trajtimin e përgjithshëm arkitektonik të brendësisë dhe më tepër të pamjes së jashtme, dallojmë ndryshime të rëndësishme. Në këtë kohë, në banesën gjirokastrite vërehen përpjekje për barastrajtimin e pamjes së jashtme me brendësinë. Dritaret relativisht të mëdha, mbuluar me arkitra dhe kornizuar me façatura druri, strehët e mbyllura dhe relativisht jo tepër të gjera, përdorimi në disa raste i erkereve dhe suvatimi i pamjes së jashtme, i japin tashti një aspekt të ri kësaj banese.

Vetë realizimet e shquara që arriti kjo banesë, sidomos në variantet e zhvilluara të saj dhe paralelet me banesat e tipeve të tjera, veçanërisht të tipit me çardak, të shtyjnë të zgjerosh në kohë dhe vend rrethin në të cilin u formua ky tip banese. Kështu, skeleti kompozicional i kësaj banese ka një rrugë të qartë evolutive, që i ka rrënjët në banesën e njohur perpendikulare shpesh me gjysmëkat, e cila është e njohur në truallin tonë që në shek. XIV, siç tregojnë ndërtimet në fshatin rrënojë të Kamenicës (Sarandë) e gjetkë. Kjo banesë e thjeshtë gjeti kushte të përshtatshme zhvillimi në Gjirokastër dhe, brenda një kohe relativisht të shkurtër, arriti në kompozime të zhvilluara, gjithë duke ruajtur disa njësi bazë kompozicionale, që të kujtojnë variantin e thjeshtë. Por, në rrugën e zhvillimit, kjo banesë u pasurua në trajtimin e saj arkitektonik dhe veçanërisht në atë të brendësisë, me realizime që nuk mund të vështrohen pa u kapur në lidhje më të gjerë territoriale dhe kohore. Kështu, shumë elemente i gjejmë në mbarë banesën qytetare shqiptare, disa të tjera kanë shtrirje panballkanike. Po dhe vetë këto elemente arkitektonike nuk kanë qëndruar si realizime të pandryshuara. Ato janë shkrirë organikisht në mbarë trajtimin e banesës. Pra, banesa gjirokastrite është një realizim që, gjithë duke qenë në themelin e saj një krijimtari origjinale, siç e provon zhvillimi logjik planimetriko-volumor, përvetësoi organikisht mjaft realizime, të cilat i ndeshim dhe jashtë këtij tipi sidomos përsa i përket trajtimit të brendësisë.

Tiparet e veçanta të banesës gjirokastrite e gjejnë shpjegimin në kushtet ekonomiko-shoqërore të jetës së kësaj qendre, e cila krahas tipareve të përbashkëta me qytetet e tjerë të vendit, dallohej dhe për tipare të veçanta, të cilat qëndrojnë në bazën e zhvillimit dhe të arritjeve të banesës gjirokastrite. Ky qytet, në dallim nga qendrat e tjera të mesjetës së vonë, si Berati, Elbasani apo Shkodra, të njohura si qendra zejtaro-tregtare, ishte deri vonë, nga fundi i shek. XIX, qendër administrative dhe shkëmbimi. Shtresa e pronarëve të tokave ishte e fuqishme në qytet. Ajo, duke pasur mjetet e duhura, në vazhdën e diferencimit përherë dhe më të theksuar klasor, arriti të materializojë me punën e mjeshtrave të talentuar variante përherë e më të zhvilluara banesash. Grindjet ndërmjet feudalëve, pra, anarkia feudale, momenti klasor dhe shkaqe të tjera, kushtëzuan mjaft nga tiparet e banesës gjirokastrite, ndërmjet të cilave shquan tipari mbrojtës.

Ndërtimet në Gjirokastër, gjatë shumë shekujsh, deri vonë para Çlirimit të vendit, janë vepër e mjeshtrave të talentuar popullorë. Epiteti popullor, së pari, lidhet me faktin se, për ta shkollë qe përvoja shumëshekullore, që kalonte nga një brez në tjetrin. Së dyti, ky cilësim tregon se mjeshtrat i përkisnin popullit, d.m.th. klasave të shfrytëzuara, që siguronin jetesën me punën e tyre. Ata ishin të organizuar në grupe prej 15-20 anëtarësh, me një kryemjeshtër. Krahinat që kanë ushtruar më shumë mjeshtëritë ndërtimore, prej të cilave kanë dalë dhe ata që kanë punuar në Gjirokastër, janë ato të Kolonjës dhe Dangëllisë. Duke pasur parasysh realizimet vërtet të shquara ndërtimore edhe në Gjirokastër, del figura e mjeshtrit të talentuar shqiptar. Ashtu si mbarë ndërtuesit popullorë, ata qenë autorë të projektit dhe realizues të tij. Ky unitet organik, apo, më saktë, këto dy faza të të njëjtit proces, janë tipar thelbësor i kësaj krijimtarie popullore, tipar që ka kushtëzuar edhe racionalizmin e theksuar të këtyre veprave arkitektonike. Një tipar tjetër i rëndësishëm i veprave të këtyre mjeshtrave është edhe mbarësia e theksuar funksionale, gjetja e vendit të përshtatshëm për çdo hollësi, etj. Kjo shpjegohet me njohjen e thellë të mënyrës së jetesës, e cila i lejonte mjeshtrit të zgjidhte drejt dhe me shije çdo kërkesë funksionale. Përvoja shumëshekullore që mjeshtrat kishin grumbulluar, si dhe intuita e shquar teknike, ishin faktorët që kushtëzuan ndërtime të goditura me dy materialet bazë ndërtimore, gurin dhe drurin. Nuk mund të mënjanohet edhe forca e madhe përfytyruese, pa të cilën ishte i pamundur realizimi i aq ndërtimeve, që shpesh paraqesin probleme të vështira teknike. Me ndërtimet e Gjirokastrës, gjenia popullore ka arritur kulme të tilla, të cilat tregojnë qartë për aftësitë e pashtershme, shpirtin krijues dhe zotësinë për të ecur me pjekuri në fushën e artit të ndërtimit, duke i shtuar parreshtur përvojës gjëra të reja.

GJIROKASTRA
QYTET - MUZE

*
* *

Me kujdesin e vazhdueshëm të Partisë dhe të Shtetit socialist për trashëgiminë pozitive të së kaluarës, pra edhe të asaj në fushën e arkitekturës, u krijuan kushte për vlerësimin dhe vënien në mbrojtje të ansambleve të mëdhenj në Gjirokastër. Me vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave, më 1961 Gjirokastra u shpall qytet-muze dhe u vu në mbrojtje shtetërore. Që prej daljes së këtij vendimi, filloi puna e gjerë kërkimore për studimin dhe klasifikimin e ndërtimeve, si dhe ajo për restaurimin e tyre. Si rezultat i kësaj pune, në vitin 1973 u aprovua rregullorja mbi mbrojtjen dhe administrimin e qytetit-muze të Gjirokastrës, lista e monumenteve të kategorisë së parë dhe zonifikimi i qytetit.

Në bazë të studimit për zonifikimin e qytetit-muze të Gjirokastrës, pra, për klasifikimin e ansambleve të tij simbas vlerave, ai u nda në dy njësi të mëdha: në qendrën historike dhe në zonën e lirë. Qendra historike përbëhet nga zona muze dhe zona e mbrojtur.

Zona muze, e cila përmbledh ansamblet më me vlerë të qendrës historike, ruhet në tërësinë e saj si kompleks arkitektonik urbanistik dhe ambiental. Zona e mbrojtur, është pjesa tjetër e qendrës historike, e cila ruan gjithashtu vlera me rëndësi. Zona e lirë është pjesa e qytetit që nuk përfshihet në qendrën historike.

Monumentet në qytetin-muze, sipas vlerës së tyre, ndahen në dy kategori: në monumente të kategorisë së parë dhe në monumente të kategorisë së dytë.

Monumentet e kategorisë së parë janë shembujt me vlera të shënuara tipologjike, apo që përmbajnë vlera të rëndësishme arkitektonike. Monumentet e kategorisë së dytë janë të gjitha ndërtimet e tjera, që ruhen brenda kufijve të qendrës historike.

Vënia në mbrojtje shtetërore e qytetit-muze të Gjirokastrës është padyshim e lidhur me kryerjen e punimeve të gjera restauruese, të cilat sigurojnë ruajtjen e kësaj trashëgimie me tërë autenticitetin e saj; dëshmi me vlera të dyfishta si vepër arti dhe dokument historik. Pikërisht fill pas vënies në mbrojtje të kësaj qendre, u ngrit ateljeja e restaurimit. Krijimi i Institutit të Monumenteve të Kulturës, më 1965, u dha një hov të madh punimeve restauruese edhe në këtë qytet; ato u rritën si në volum ashtu dhe në cilësi. Në vitin 1973, Ateljeja e Monumenteve të Kulturës u kthye në Degë të Monumenteve, gjithmonë brenda kuadrit të Institutit të Monumenteve të Kulturës, duke krijuar kështu kushtet për zgjërimin dhe thellimin e mëtejshëm të ndërhyrjeve restauruese.

Deri më sot, në qytetin-muze të Gjirokastrës janë kryer ndërhyrje të rëndësishme konservimi dhe restaurimi, në kala dhe në pazarin e qytetit nga kuadro të dala prej auditorëve të Universitetit të Tiranës, por volumi më i madh i këtyre punimeve u përket banesave, që përbëjnë pjesën kryesore të ndërtimeve të qytetit. Punimet restauruese në banesa kanë synuar të ruajnë, sa më shumë që të jetë e mundur, elementet dhe kompozimin origjinal, duke ndërhyrë në monumentet vetëm në rastet kur paraqitej rreziku i degradimit dhe kur në to ishin bërë ndryshime apo shtesa pa kriter, që kishin dëmtuar vlerat e monumentit. Sipas rastit, mbas studimeve të imta në vend, janë bërë dhe punime plotësimi, veçanërisht në elemente të veçantë arkitektonikë, gjithmonë duke respektuar parimet e shëndosha të restaurimit, që shohin te monumenti në radhë të parë dokumentin historik. Restaurimi i këtyre banesave i ka zgjidhur dy anët e problemit, evidentimin dhe ruajtjen e mëtejshme të vlerave të monumentit dhe përmirësimin e kushteve të jetës së banorëve. Një numër më i vogël prej tyre janë kthyer në objekte shoqërore dhe muzeume.

Qyteti-muze i Gjirokastrës jeton dhe do të jetojë me kohën, me të renë socialiste, prandaj në përputhje me rregulloren për mbrojtjen dhe restaurimin, pa dëmtuar vlerat e këtij qyteti, janë ngritur dhe do të ngrihen një seri objektesh, shoqërore, industriale dhe banimi. Brënda qendrës historike, nevojat për objekte shoqërore janë plotësuar nëpërmjet adaptimit të monumenteve të kategorisë II, siç u veprua me adaptimin e një banese për Poliklinikën e qytetit në lagjen Hazmurat. Ndërtimet në zonën e lirë do të krijojnë shkallë-shkallë ansamble të reja që nuk do të zbehin vlerat e qëndrës historike.

* * *

Gjirokastra shquan krahas arkitekturës së saj, që të lë mbresa të pashlyshme, dhe për kontributin e shquar në historinë e popullit tonë. Ajo, gjatë gjithë kohës, ka qenë një vatër e luftës kundër pushtuesve të huaj dhe pabarazisë shoqërore. Shoku Enver Hoxha, duke folur për traditat patriotike e revolucionare të këtij qyteti shkruan: «...Gjirokastra jonë është qytet-muze, në radhë të parë, për historinë e saj të lavdishme patriotike e revolucionare, për luftërat dhe përpjekjet e pareshtura të bijve dhe bijave të saj për liri dhe pavarësi, për gjuhën dhe për shkollën shqipe, për demokraci, zhvillim e përparim të gjithanshëm ekonomik e shoqëror»[1]. Ky vlerësim i shokut Enver flet qartë për kontributin e madh që dhanë bijtë e bijat e këtij

1) Enver Hoxha, «Përshëndetje drejtuar popullit të Gjirokastrës», gazeta «Zëri i popullit», 25 Maj 1977.

GJIROKASTRA
QYTET - MUZE

qyteti me histori plot përpjekje në luftën e madhe për pavarësi e drejtësi shoqërore. Në vazhdën e përpjekjeve shumëshekullore patriotike e revolucionare, shquan periudha e Rilindjes sonë. Gjirokastra e ndjeu fuqimisht lëvizjen e madhe të Rilindjes Kombëtare, duke dhënë në këtë lëvizje kontributin e vet të madh me pushkën dhe penën e bijve të saj më të mirë. Emrat e patriotëve Bajo e Çerçiz Topulli si dhe të shumë të tjerëve që kanë folur me penë dhe me pushkë për lirinë dhe pavarësinë e vendit, janë një shembull i shkëlqyer i luftës heroike që njohu, ashtu si mbarë vendi, dhe ky qytet me tradita të shquara. Përpjekje të madhe bënë patriotët gjirokastritë për hapjen e shkollës shqipe, në kushtet e rënda të pushtimit të huaj, që përpiqej me çdo mënyrë të mohonte qenien e kombit dhe gjuhës shqipe. Shkolla shqipe «Liria», «trëndafili i parë i Gjirokastrës», siç e cilësoi atë shoku Enver, ishte një arritje e rëndësishme në luftën e madhe për arsim kombëtar. Gjatë viteve 1908-1924, në Gjirokastër lindin një sërë lidhjesh, shoqërish demokratike dhe klubesh politike, të cilat ishin rezultat i drejtpërdrejtë i veprimtarisë dhe përpjekjeve të patriotëve të Rilindjes. Këtu mund të përmendim klubin «Drita», shoqërinë «Kundër Bastiljes», klubin «Shpresa», shoqëritë «Kandilja» dhe «Studenti», etj.

Historinë më të lavdishme Gjirokastra e shkroi në ditët e stuhishme të Luftës Nacionalçlirimtare. Shoku Enver, duke treguar lidhjen e qartë ndërmjet traditave patriotike dhe Luftës Nacionalçlirimtare, thotë: Në këtë truall të lavdishëm, në këtë lumë të pashtershëm patriotizmi e trimërie, në këtë shkollë të madhe të jetës, u mësuan e u edukuan ata djem e vajza të popullit, që më pas, në vitet e vështira të okupacionit fashist, u bashkuan rreth Partisë Komuniste Shqiptare dhe u bënë mish e gjak i saj, u bënë heronj të lavdishëm të saj dhe të popullit»[1]. Gjirokastra u bë qendër e rëndësishme e Luftës Nacionalçlirimtare, bijt e bijat më të mirë të saj mbushën radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Shumë prej tyre dhanë jetën heroikisht për çështjen e revolucionit, si Muzo Asqeriu, Bule Naipi dhe shumë e shumë të tjerë.

Për t'u bërë sa më shumë jehonë ngjarjeve të mëdha historike që kaloi Gjirokastra, me kujdesin e vazhdueshëm të Partisë, në këtë qytet janë ngritur një numër muzeumesh, të cilët, duke dokumentuar ngjarjet e rëndësishme në jetën e qytetit, shërbejnë për edukimin patriotiko-revolucionar të masave. Një vend të rëndësishëm në këto muzeume zë «Shtëpia e vëllezërve Topulli», «Muzeu i ish-Qarkut të Gjirokastrës» si dhe «Qendra kulturore» pranë pazarit të qytetit, në qendër të së cilës ngrihet obelisku kushtuar pionierëve të arsimit, të shkollës dhe të gjuhës shqipe. Në këtë varg muzeumesh një vend me rëndësi zë «Muzeu Kombëtar i Armëve», ngritur në kalanë e Gjirokastrës, ku janë ekspozuar armët shqiptare dhe ato trofe gjatë gjithë historisë së popullit tonë. Përmendore dhe lapidare të shumtë ngrihen në mbarë qytetin, duke përkujtuar ngjarje të rëndësishme të luftës kundër pushtuesve dhe reaksionit të brëndëshëm.

Nga viti në vit Gjirokastra, në sajë të kujdesit të vazhdueshëm të Partisë rritet dhe zbukurohet ashtu si

1) Enver Hoxha, «Përshëndetje drejtuar popullit të Gjirokastrës», gazeta «Zëri i popullit», 25 Maj 1977.

mbarë vëndi. Pjesa e re e qytetit, jashtë qëndrës historike, zhvillohet me ritme të shpejta me ndërtime të shumta industriale, shoqërore e banimi. Lagjet e reja me shtëpi kulture, shkolla, kinema, kopshte, çerdhe, dhe qëndra të shërbimit shëndetësor, pa dëmtuar qytetin-muze krijojnë një kontrast të goditur ndërmjet të vjetrës dhe të resë socialiste. Zhvillim të vrullshëm ka marë në qytetin e Gjirokastrës prodhimi industrial, ndërmarrje e fabrika të reja moderne ku punojnë me qindra qytetarë nxjerrin prodhime të rëndësishme për ekonominë e vëndit.

Qyteti-muze i Gjirokastrës, sot, në sajë të punimeve sistematike restauruese si dhe ndërtimeve të reja, jashtë qendrës historike, është dëshmi bindëse e gjenisë krijuese të popullit tonë dhe e përparimit të paparë në kushtet e rendit tonë socialist.

EMIN RIZA



Qyteti

Nga vizita e udhëheqësit tonë të dashur shokut Enver Hoxha në rrethin e Gjirokastrës — Mars 1978.

Pamje e kalasë, gravurë e shek. XIX.



Pamje e kalasë dhe «urave të mëdha», gravurë e shek. XIX.

Pamje e një pjese të «urave të mëdha» shkatërruar më 1932.

Pamje e urës të ujësjellësit të kalasë, mbi lagjen Manalat.

Pamje e kalasë së Gjirokastrës – shek. XIII.



Pamje e kalasë nga hyrja lindore.

Porta e kalasë nga hyrja lindore.

Pamje e kalasë nga perëndimi.

Pamje e kalasë dhe e lagjeve Pazar i vjetër e Pllakë

Porta kryesore e kalasë

Pamje e brendshme e kalasë me ambientet e rindërtuara nga Ali Pashë Tepelena.

Grupi artistik i pionierëve të shkollës 8 vjeçare «Naim Frashëri» të lagjes Manalat.

Pamje e ambienteve të brendshme të kalasë.



Pamje e qytetit.

Pamje e lagjeve Pazar i Vjetër dhe Pilakë

Rrugë në lagjen Cfakë

Pamje e pjesshme
e lagjes Hazmurat

Rrugë në lagjen Hazmurat



Pamje e lagjes Palorto

Rrugë në lagjen Teqe

Pamje e lagjes Cfakë

Pamje e lagjes Manalat

Pamje e pjesshme e lagjes Dunavat

Rrugë në lagjen Pazar i Vjetër.

Rrugë në lagjen Dunavat



Rrugë në lagjen Meçite

Pamje rruge në lagjen Varosh

Pamje e Qafës së Pazarit dhe Obeliskut

Pamje nga pazari i qytetit

Sheshi «Çerçiz Topulli»

Rrugë dhe dyqane të pazarit

Rrugë karakteristike e pazarit

Pamje e pjesshme e pazarit dhe lagjes Teqe

Rrugë në pazar

Kisha në lagjen Varosh – ndërtuar më 1776
dhe rindërtuar më 1833 pas djegjes.

Xhamia e pazarit – viti 1757

Xhamia në lagjen Dunavat



Banesa

Banesë e variantit perpendikular



Lagje Palorto — banesë e variantit perpendikular (pas restaurimit).

Lagja Dunavat — Banesë me një krah — viti 1824

Tavan dekorativ i një banese në lagjen Meçite – viti 1791

Portë e vitit 1791



Tavan dekorativ — gjysma e dytë e shek. XVIII.

Tavan dekorativ — gjysma e dytë e shek. XVIII.

Sterë me marrje uji në formë pusi — Lagja Pazar i Vjetër



Banesë me dy krahë me kamerie — Lagja Teqe



Lagjia Palorto. Rr. P. Xhixho. Nr. 16.
Banesë tipike, me dy krahë me kamerie, fillimi i shek. XIX.

Lagjia Palorto, Rr. P. Xhixho. Nr. 16.
Pamja e portës së jashtme lindore (pas restaurimit).



Lagjia Palorto Rr. P. Xhixho. Nr. 16.
Pamja kryesore (pas restaurimit).



Lagjia Palorto, Rr. P. Xhixho. Nr. 16. Oxhaku dekorativ i odës së miqve.

Lagja Palorto, Rr. P. Xhixho. Nr. 16. Piktura murale në oden e miqve.

Lagja Palorto, Rr. P. Xhixho. Nr. 16. Tavan dekorativ i qoshkut të odës së miqve.

Lagja Manalat, Rr. Z. Baboçi Nr. 12. Banesë me kamerie të mbyllur, viti 1825.



Lagja Manalat, Rr. Z. Baboçi, Nr. 12. Dyer të brendëshme që dalin në çardak.

Lagja Manalat, Rr. Z. Baboçi, Nr. 12, Tahta-posh mbi kafazin e shkallëve.

Pamje e pjesshme e dy banesave në lagjen Dunavat

Banesë në lagjen Varosh, Rr. M. Mame, Nr. 6, viti 1821



Banesë në lagjen Varosh, Rr. M. Mame, Nr. 6, Pamje e hajatit



Lagja Palorto, Rr. M. Bakiri Nr. 5. Banesë me kamerie të mbyllur viti 1827.

Lagja Palorto, Rr. M. Bakiri, Nr. 5. Piktura murale në ballin e odës së miqve.

Lagja Palorto, Rr. M. Bakiri, Nr. 5. Piktura murale në faqen e jashtme, përbri kameriesë.



Lagja Palorto, Rr. M. Bakiri. Nr. 5. Rozeta
e tavanit të odës së miqve.

Lagja Palorto, Rr. M. Bakiri. Nr. 5. Pamje
e odës së miqve



Lagja Palorto, Rr. M. Bakiri. Nr. 5. Dollap muri



Oborr i një banesë në lagjen Pazar i Vjetër

Lagja Dunavat, Rr. M. Reso. Nr. 7. Banesë me një krah, fillimi i shek. XIX.

Lagja Dunavat Rr. S. Musaj. Nr. 10. Dollap muri i daltuar në dru.



Lagja Dunavat, Rr. S. Musaj, Nr. 10. Rozetë e tavanit të odës së miqve.

Lagja Dunavat, Rr. S. Musaj, Nr. 10
tura murale në oděn e miqve.

Lagja Palorto, Rr. A. Toto, Nr. 24. Banesë me dy krahë, viti 1825.



Lagja Palorto, Rr. A. Toto, Nr. 24. Pamje e ballit të divanit.

Lagja Palorto, Rr. A. Toto, Nr. 24. Pamje e nëndivanit.

Lagja Dunavat, Rr. M. Reso, Nr. 12. Banesë me një krah, ndërtuar më 1831, rindërtuar më 1865 dhe 1873.

Lagja Dunavat, Rr. M. Reso, Nr. 12. Pamje e sqollit të divanit.

Lagja Teqe. Banesë me një krah, fillimi i shek. XIX.

Lagja Teqe. Mur rrethues me kontraforca.





Tavan dekorativ i odës së miqve, fillimi i shek. XIX.

Rozetë tavani, fillimi i shek. XIX.



Portë e jashtme në lagjen Meçite.

Lagja Palorto, Rr. Th. Vasi, Nr. 2. Banesë e zhvilluar me dy krahë, viti 1823.

Lagja Falorto, Rr. Th. Vasi, Nr. 2. Pamje e pjesshme e çardakut.

Lagja Palorto, Rr. Th. Vasi, Nr. 2. Pamje dere.

Lagja Palorto, Rr. Th. Vasi, Nr. 2. Tavanet e odës së miqve.

Lagja Palorto, Rr. Th. Vasi, Nr. 2. Kompleksi musandër-dhipato në oden e miqve.

Portë e jashtme në lagjen Pazar i Vjetër.

Lagja Dunavat, Rr. M. Reso, Nr. 17. Banesë me një krah, rindërtuar më 1838.



Lagja Dunavat, Rr. M. Reso, Nr. 17, Dritare e divanit.

Lagja Dunavat Rr. M. Reso,
Nr. 17. Oda e miqve.



Lagja Dunavat Rr. M. Reso,
Nr. 17, Dollap muri

Vendmarrje e ujit nga stera.



Detaj i musandrës.



Lagja Dunavat, Rr. M. Reso, Nr. 17. Kompleksi musandër-dhipato në oden e miqve.

Guri i kafesë në banesën gjirokastrite.



Detaj i musandrës.

Lagja Dunavat, Rr. M. Reso, Nr. 17. Kompleksi musandër-dhipato në odën e miqve.

Guri i kafesë në banesën gjirokastrite.



Detaj i musandrës.



Lagja Dunavat, Rr. M. Reso, Nr. 17. Kompleksi musandër-dhipato në oden e miqve.

Guri i kafesë në banesën gjirokastrite.

Pamja anësore e një banese me një krah, në lagjen Dunavat, viti 1872.

Tymare karakteristike gjirokastrite.

Vendmarrje uji nga stera, në formë pusi.

Dritare katoi



Lagja Palorto. Rr. R. Hoxha, Nr. 11, Banesë me një krah, viti 1879.



Pamje oxhaku



Lagja Palorto. Rr. R. Hoxha, Nr. 11. Tavan i odës së miqve

Dollap muri

Banesë për dy vëllezër në lagjen Teqe, viti 1881.

Portë e jashtme me qemer

Lagja Meçite, Rr. A. Kondi, Nr. 4. Pamje e një ode, viti 1891-2.

Trokitse dere



Bravë dere

Derë e brendshme, e siguruar me katarah

Çift oxhakësh

Lagja Cfakë, portë e jashtme



Pamje e një kopshti në periferi të lagjes
Dunavat

Portë e oborrit të dytë

Lagja Cfakë, portë e jashtme



Vendmarrje uji nga stera, në formë pusi

Lagja Cfakë, portë e jashtme



Rrugë në lagjen Dunavat

Mur rrethues oborri

Lagja Dunavat, Banesë e dalë në katin e parë në formë erkeri, viti 1889.



Restaurimi



Plani i zonifikimit të qytetit-muze të Gjirokastrës



«Qafa e Pazarit», pas punimeve të restaurimit

«Qafa e Pazarit», gjatë punimeve të restaurimit



Banesë në lagjen Palorto, viti 1823, gjendja mbas restaurimit

Banesë në lagjen Palorto, viti 1823, gjendja para restaurimit



«Qafa e Pazarit», pas punimeve të restaurimit

«Qafa e Pazarit», gjatë punimeve të restaurimit

Banesë në lagjen Palorto, viti 1823, gjendja mbas restaurimit

Banesë në lagjen Palorto, viti 1823, gjendja para restaurimit

Banesë në lagjen Teqe (gjatë punimeve të restaurimit).

Banesë në lagjen Teqe (gjendja para restaurimit).

Banesë në lagjen Dunavat, viti 1879 (gjendja pas restaurimit)

Banesë në lagjen Dunavat, viti 1879 (gjendja para restaurimit).

Banesë në lagjen Teqe (gjendja pas restaurimit).

Banesë në lagjen Teqe (gjendja para restaurimit).

Banesë në lagjen Teqe (gjendja pas restaurimit).

Dicitura sipër të lexohet:
Banesë në lagjen Teqe
(gjendja para restaurimit)

Dicitura poshtë të lexohet:
Banesë në lagjen Teqe
(gjendja pas restaurimit)

Banesë në lagjen Teqe (gjendja para restaurimit).

Banesë në lagjen Teqe (gjendja pas restaurimit).

Banesë në lagjen Teqe (gjatë punimeve të restaurimit).





Pamje e përgjithshme e qytetit

Instituti i lartë pedagogjik

Instituti i lartë pedagogjik, studentë gjatë praktikës në laboratorin e fizikës.

Instituti i lartë pedagogjik

Instituti i lartë pedagogjik, studentë gjatë praktikës në laboratorin e fizikës.

Pamje e ndërtimeve të reja në zonën e lirë të qytetit-muze.

Pamja e uzinës metalike

Hoteli turistik «A. Z. Çajupi»

Ndërtime të reja në zonën e lirë

Hoteli turistik «A. Z. Çajupi»

Ndërtime të reja në zonën e lirë

Stadiumi «Subi Bakiri»



Monumente historikë



Busti i shokut Enver Hoxha në hyrje të qytetit

Banesa e vëllezërve Topulli, kthyer në muze historik (pas restaurimit).

Hyrja e banesës së vëllezërve Topulli

Banesa e vëllezërve Topulli, kompleksi muzandër-dhipato i odës së miqve.

Banesë e vëllezërve Topulli, Pamja e divanit.

Monumenti i luftëtarit të rilindjes Çerçiz Topulli

Ndërtesa ku më 22 Qershor 1880 u mblodh dega e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Obelisku kushtuar pionierëve të arsimit, të shkollës dhe të gjuhës shqipe.

Pamje e pjesshme e obeliskut

Grupi folklorik i pleqve të Gjirokastrës



Klubi politik «Drita» formuar 5 Nëndor 1908 dhe Mësimorja «Lirija» – 19 Maj 1908.

Mësimorja «Lirija» – kthyer në muze

Klubi politik «Drita» — kthyer në muze



Ish selia e shoqërisë «Kundra Bastiljes» — 26 Mars 1921 dhe Klubi Opingarve «Shpresa» — 1922, të kthyera në muze.

Ballkoni i klubit opingarve «Shpresa», nga ku Avni Rustemi i foli popullit të Gjirokastrës në Janarin e vitit 1921.

Varret e patriotëve dhe luftëtarëve të rilindjes Bajo Topulli, Çerçiz Topulli dhe Andon Z. Çajupi.

Dhoma muze e mësuesit të popullit Thoma Papapano

Muzeu i luftës nacionalçlirimtare të ish Qarkut të Gjirokastrës.

Muzeu i luftës nacionalçlirimtare të ish Qarkut të Gjirokastrës, gjatë vizitave.



Një nga sallat e muzeut të luftës nacionalçlirimtare të ish Qarkut të Gjirokastrës, gjatë vizitave.

Oda ku lindi shoku Enver Hoxha, udhëheqësi i madh i Partisë dhe popullit shqiptar.

Një nga sallat e muzeut të luftës nacionalçlirimtare të ish Qarkut të Gjirokastrës, gjatë vizitave.

1942
MEI 6 MARS
NXENESIT DHE
MESUESIT
E GJIMNAZIT
UPERLESHEN
ME FORCAT
E FASHIZMIT

Përmendore kushtuar përleshjes së nxënësve dhe mësuesve të gjimnazit me forcat e fashizmit.

Përmendore kushtuar qendresës kundër pushtuesve nazi-fashistë.

Busti i heroinave Bule Naipi dhe Persefoni Kokëdhima.

Salla qendrore e muzeut kombëtar të armëve në kalanë e qytetit.

Pamje nga hyrja në muzeun kombëtar të armëve.

Pamje vitrinash me armë mesjetare.

Një nga sallat e muzeut kombëtar të armëve gjatë vizitave.

Salla me armë të përdorura gjatë luftës nacionalçlirimtare.

Homazhe në varrezat e dëshmorëve me rastin e 5 Majit, ditës së dëshmorëve të luftës nacionalçlirimtare.

Lule të freskëta mbi varret e dëshmorëve.

Përkujtojnë ngjarje të luftës nacionalçlirimtare.

Përmendore kushtuar dëshmorëve të lagjes Hazmurat gjatë luftës nacionalçlirimtare.

Përmendore kushtuar dëshmorëve të lagjes Dunavat gjatë luftës nacionalçlirimtare.

Përmendore kushtuar dëshmorëve të lagjes Palorto, gjatë luftës nacionalçlirimtare.

Përmendore kushtuar dëshmorëve të lagjes Varosh gjatë luftës nacionalçlirimtare.

Përmendore kushtuar dëshmorëve të lagjes Manalat gjatë luftës nacionalçlirimtare.

Pamje e përgjithshme e qytetit-muze.

INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS

Përgatitur nga:

EMIN RIZA

Fotot:

REFIK VESELI

Formulimi artistik nga:

FARUK ZARSHATI

Tirazhi 5000 kopje Format 78x109/12 Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë, 1978